

URDHËR
Nr. 144, datë 27.7.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 13, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 7, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, të ndryshuar, nenit 56, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për procedurat e prokurimit publik, te znj. Laerta Rooze, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
 2. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.
 3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Albana Shtylla